DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

# RAPORTI VJETOR 2018

PËRMBAJTJA


**HYRJE** .......... 5

**II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE** .......... 7

Grafik 1. Struktura e të ardhurave .......... 10

Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2018 .......... 10

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2018 sipas DRT-ve (000 lekë) .......... 11

Tabela 3. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 lekë ) .......... 12

Tabela 4. Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 lekë ) .......... 12

Tabela 5. Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 lekë ) .......... 13

Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zërave (000 lekë ) .......... 13

Tabela 7. Të ardhurat nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 lekë ) .......... 14

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore) .......... 15

Tabela 9. Të ardhurat nga Taksa e Qarkullimit dhe Karburantit (000 lekë ) .......... 16

Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore .......... 16

**III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE** .......... 17

Tabela 11. Përshkrimi i kontakteve dhe shërbimeve të ofruara 2018 .......... 18

Tabela 12. Përshkrimi i vërtetimeve të lëshuara nga funksioni i shërbimit .......... 18

Tabela 13. Vërtetime të lëshuara nëpërmjet Portalit e-Albania .......... 18

**IV. KONTROLLI TATIMOR** .......... 23

**V. MENAXHIMI I RISKUT** .......... 28

**VI. MBLEDHJA ME FORCË** .......... 34

Grafik 2. Struktura e borxhit tatimor sipas llojit të tatimit .......... 35

Grafik 3. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2017 vs 2018 .......... 35

Grafik 4. Mosha e borxhit .......... 36

Grafik 5. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit .......... 36

**VII. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE** .......... 38

**VIII. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT** .......... 40

**IX. RIMBURSIMI I TVSH-SË** .......... 41

Tabela 14. Kërkesat e pranuara gjatë vitit 2018 .......... 42

Tabela 15. Situata e rimbursimit për vitin 2018 .......... 43

Tabela 16. Rimbursimet sipas DRT-ve .......... 43

**X.MARËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL** .......... 45

**XI. MENAXHIMI I PROJEKTEVE** .......... 48

**XII. QENDRA E PAGESAVE** .......... 49

**XIII. HETIMI TATIMOR**............ 50
Grafik 6. Verifikimet në numër bazuar në plane operacionale dhe në ndjekje të shkresave sipas çdo Drejtorie Hetimi Tatimor. ............ 52
Grafik 7. Masa administrative në numër të vendosura për ata tatimpagues që nuk përmbushin legjislacionin tatimor. ............ 52
Grafik 8. Shkelje në vlerë sipas rajoneve............ 52
Tabela 17. Rezultatet e vitit 2018............ 53
Grafik 9. Referime në prokurori sipas cdo DHT gjatë vitit 2018............ 53
Grafik 10. Referime të veprave penale në prokurori ndër vite ............ 54
Grafik 11. Referimet e rasteve sipas prokurorive............ 54
Tabela 18. Denoncime/ankesa në numër ............ 55
**XIV. BURIMET NJERËZORE** ............ 56
Tabela 19. Masat disiplinore në Administratën Tatimore Qendrore për vitin 2018 ............ 60
Tabela 20. Vlerësimet e nëpunësve civilë në Administratën Tatimore 6 mujori i parë 2018............ 62
Tabela 21. Vlerësimet e nëpunësve civilë në Administratën Tatimore 6 mujori i dytë 2018............ 62
Tabela 22.Vlerësimet vjetore të strukturës së Hetimit Tatimor në Administratën Tatimore ............ 63
Tabela 23. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore. ............ 63
**XV. BUXHETI DHE FINANCA**............ 64
Tabela 24. "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve Buxhetorë" (000 lekë ) ............ 66
Tabela 25. "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve" (000 lekë )............ 67
Tabela 26. " "Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim te huaj" (000 lekë ) ............ 68
**XVI. DIBA** ............ 69
**XVII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PROKURIMEVE**............ 70
Tabela 27. Regjistri i Prokurimeve për vitin 2018 ............ 70
Tabela 28. Investimet DPT............ 72
Tabela 29. Realizimi i kontratës 2018 së biletave të transportit rrugor me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë 73
Tabela 30. Realizimi i kontratës 2018 së pullave me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë"............ 74
Tabela 31. Realizimi i kontratës së dokumentacionit tatimor për vitin 2018 ............ 74

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit, www.tatime.gov.al

| **Shkurtime** | |
|---|---|
| **DPT** | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| **DRT** | Drejtoria Rajonale Tatimore |
| **TVSH** | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar |
| **TAP** | Tatimi mbi të Ardhurat Personale |
| **DPD** | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave |
| **RPA** | Regjimi i Përpunimit Aktiv |

# HYRJE

Raporti vjetor është një pasqyrë e veprimtarisë dhe rezultateve të Administratës Tatimore gjatë vitit 2018 në raport me objektivat e Planit Strategjik 2017-2021 dhe planeve operacionale të vitit 2018.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin, mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1,569 punonjës, duke e renditur Administratën Tatimore si një nga institucionet ligjzbatuese më të rëndësishme në vend.

Mbledhja e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, synohet të realizohet nëpërmjet nxitjes së përmbushjes vullnetare, si edhe duke kërkuar nga të gjithë tatimpaguesit kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Në këtë frymë, Administrata Tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vende anëtare të BE-së, që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushje të nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasa të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive, të cilat do t'i gjeni në treguesit statistikorë të këtij raporti.

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Administrata Tatimore Qendrore synon rritjen e besimit publik, nëpërmjet zhvillimit dhe garantimit të një kulture organizative të bazuar në parimet e mëposhtme:

- *Zbatimi i ligjit, barazia dhe drejtësia;*
- *Përgjegjësia, ndershmëria, transparenca;*
- *Efektiviteti, efikasiteti, besueshmëria*

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

- Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:
    - Ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore;
    - Rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri;
- Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:
    - Zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut
    - Përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore;
    - Mbledhjes efikase dhe efektive të borxhit.
- Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes;
    - Aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne;
    - Zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve;
    - Mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore;
    - Zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve;
    - Modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës;
    - Rritjes cilësore të komunikimit në raport me gjetjet e vitit 2017 (transparencën, komunikimin me biznesin, aksesin në kohë dhe cilësinë e informacionit),
    - Përmirësimit në komunikimin dhe shërbime ndaj tatimpaguesve në periudhën 2017 – 2018;
    - Kënaqësisë nga shërbimet elektronike të tatimeve, dukshëm më e lartë në 2018 në të gjitha aspektet e vlerësuara, si: aksesi, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave;
    - Rritjes së konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, sjelljen dhe etikën e inspektorëve,
    - Rritjes së ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektim bazuar në të.

# II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE

## Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018 një ndër objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale;
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit;
- Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirëadministrim;
- Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve;

Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:

- Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte në rritjen e tyre;
- Forcimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë;
- Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore;

### 2.1. Të ardhurat gjithsej

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12 mujore 2018, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

### Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- Të ardhurat tatimore neto përbëjnë **62 %** të të ardhurave totale.
- Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përbëjnë **38 %** të të ardhurave totale neto.

Për vitin 2018, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 247 miliardë lekë dhe janë realizuar 246.6 miliardë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 0.4 miliardë lekë ose 0.18% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, me realizim të ardhurash 228.6 miliardë lekë, rritja e të ardhurave tatimore është 18 miliardë lekë më shumë ose 7.87% më shumë.
Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

### Të Ardhurat Tatimore

Për vitin 2018, të ardhurat tatimore janë programuar 159.1 miliardë lekë dhe janë realizuar 157.8

miliardë lekë, me një mosrealizim prej 1.3 miliardë lekë ose 0.83% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën të ardhurat u realizuan 145.8 miliardë lekë, rezultatet janë në rritje me 12 miliardë lekë më shumë ose 8.26% më shumë.

### Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2018, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 87.9 miliardë lekë dhe janë realizuar 88.8 miliardë lekë , me një rritje prej 0.9 miliardë lekë ose 1% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 82.8 miliardë lekë, rezultatet janë në rritje me 6 miliardë lekë më shumë ose 7.20 % më shumë.

## 2.2. Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2018 dhe faktin e vitit 2017, për periudhën Janar – Dhjetor 2018, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

### *2.2.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar*

Për 12 mujorin 2018, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 38.1 miliardë lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 36.5 miliardë lekë, më një mosrealizim në vlerë prej 1.7 miliardë lekë ose 4.3% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën u arkëtuan 35 miliardë lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 1.5 miliardë lekë më tepër, ose 4.17 % më shumë.

### *2.2.2. Rimbursimi i TVSH-së*

Për 12 mujorin 2018, rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 15 miliardë lekë dhe është realizuar në vlerën 14.4 miliardë lekë, me një mosrealizim prej 0.6 milionë ose 4.02% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017 në të cilën janë rimbursuar 13.9 miliardë lekë, rimbursimet janë realizuar 0.5 miliardë lekë ose 3.64% më shumë.

### *2.2.3. Tatimi mbi Fitimin*

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 33.8 miliardë lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 34.4 miliardë lekë, me një mbirealizim prej 0.6 miliardë lekë ose 1.75 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën u arkëtuan 31.6 miliardë lekë, të ardhurat

nga ky lloj tatimi janë realizuar 2.8 miliardë lekë më tepër ose 8.91% më shumë**.**

### *2.2.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale*

Tatimi mbi të Ardhurat Personale është programuar 36.8 miliardë lekë dhe është realizuar 36.5 miliardë lekë, me një mosrealizim prej 0.2 miliardë lekë ose 0.61% më pak.
Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 32.1 miliardë lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 4.4 miliardë lekë më tepër ose 13.78 % më shumë.

### *2.2.5. Taksat Kombëtare dhe Tarifa*

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 13.1 miliardë lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 12.6 miliardë lekë, me një mosrealizim 0.4 miliardë lekë ose 3.26% më pak.
Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën u arkëtuan 12.42 miliardë lekë, mbledhja e taksave është realizuar me një rritje prej 0.2 miliardë lekë ose 1.90% më shumë.

### *2.2.6. Taksa e Qarkullimit Rrugor*

Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 16.4 miliardë lekë, janë arkëtuar 18.3 miliardë lekë, me një mbirealizim në vlerë prej 1.9 miliardë lekë ose 11.5% më shumë.
Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, në të cilën u arkëtuan 15.1 miliardë lekë, të ardhurat janë realizuar me rritje prej 3.2 miliardë lekë ose 21.1% më shumë.
*Kjo taksë mblidhet nga agjentë, kryesisht Doganat.*

### Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12 mujore 2018

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

- TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të ardhurat publike me 32% të të ardhurave tatimore.
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale përbën 23 % të të ardhurave tatimore,
- Tatimi mbi Fitimin zë 22 % të të ardhurave tatimore,
- Taksa e qarkullimit dhe karburantit me 12% të të ardhurave tatimore.

## Grafik 1. Struktura e të ardhurave




## Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2018

| | E M E R T I M I | FAKTET | | PLANI | Diferenca Fakt Plan | | Diferenca 2018- 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2017 | 2018 | 2018 | + ose - | Përqindje | + ose - | Përqindje |
| | **D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)** | **228,577,581** | **246,576,742** | **247,013,000** | **(436,258)** | **-0.18%** | **17,999,161** | **7.87%** |
| **A** | Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim) | **145,760,105** | **157,798,662** | **159,113,000** | **(1,314,338)** | **-0.83%** | **12,038,557** | **8.26%** |
| **1** | TVSH (bruto) | 48,935,239 | 50,903,912 | 53,160,000 | (2,256,088) | -4.24% | 1,968,673 | 4.02% |
| | - TVSH (neto) | 35,044,454 | 36,507,129 | 38,160,000 | (1,652,871) | -4.33% | 1,462,675 | 4.17% |
| | - Rimbursimi i kryer | 13,890,786 | 14,396,783 | 15,000,000 | (603,217) | -4.02% | 505,997 | 3.64% |
| **2** | Tatim mbi Fitimin | 31,599,398 | 34,413,962 | 33,823,000 | 590,962 | 1.75% | 2,814,564 | 8.91% |
| **3** | Ardhura Personale | 32,144,054 | 36,575,099 | 36,800,000 | (224,901) | -0.61% | 4,431,045 | 13.78% |
| **4** | Taksat Nacionale | 12,418,438 | 12,654,138 | 13,080,000 | (425,862) | -3.26% | 235,700 | 1.90% |
| **5** | Taksa e Qarkullimit mbi Karburanitin | 15,155,586 | 18,347,259 | 16,450,000 | 1,897,259 | 11.53% | 3,191,674 | 21.06% |
| **6** | Lojerat e Fatit | 5,349,807 | 4,614,389 | 5,800,000 | (1,185,611) | -20.44% | (735,418) | -13.75% |
| **7** | Te tjera pa identifikuar | 0 | -0.02 | 0 | -0.02 | | -0.02 | 0.00% |
| **8** | Denimet Administrative | 157,582 | 289,902 | 0 | 289,902 | | 132,320 | 83.97% |
| **B** | Te Ardhurat Tatimore (neto) | **131,869,319** | **143,401,879** | **144,113,000** | **(711,121)** | **-0.49%** | **11,532,560** | **8.75%** |
| **C** | Kontributet e Sigurimeve | **82,817,476** | **88,778,080** | **87,900,000** | **878,080** | **1.00%** | **5,960,604** | **7.20%** |
| **D** | D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto) | **214,686,795** | **232,179,959** | **232,013,000** | **166,959** | **0.07%** | **17,493,164** | **8.15%** |

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2018 sipas DRT-ve (000 lekë )

| | Te ardhura Total Bruto | | | Te ardhura Tatimore Neto | | | Sigurime Shoqerore | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Fakt | Plan | % | Fakt | Plan | % | Fakt | Plan | % |
| Berat | 3,461,022 | 3,567,000 | -2.97% | 999,456 | 917,000 | 8.99% | 2,183,134 | 2,250,000 | -2.97% |
| Diber | 3,622,235 | 3,550,000 | 2.03% | 1,649,069 | 1,520,000 | 8.49% | 1,900,183 | 1,950,000 | -2.55% |
| Durres | 14,361,273 | 13,750,000 | 4.45% | 5,249,486 | 4,392,000 | 19.52% | 7,949,239 | 7,858,000 | 1.16% |
| Elbasan | 6,341,982 | 6,400,000 | -0.91% | 1,769,381 | 1,800,000 | -1.70% | 3,951,136 | 4,000,000 | -1.22% |
| Fier | 9,800,359 | 10,546,000 | -7.07% | 4,114,106 | 4,696,000 | -12.39% | 4,727,471 | 4,650,000 | 1.67% |
| Gjirokaster | 2,687,574 | 2,780,000 | -3.32% | 935,579 | 901,000 | 3.84% | 1,668,219 | 1,749,000 | -4.62% |
| Korce | 5,458,978 | 5,500,000 | -0.75% | 1,801,812 | 1,748,000 | 3.08% | 3,408,160 | 3,452,000 | -1.27% |
| Kukes | 2,004,154 | 2,060,000 | -2.71% | 661,811 | 690,000 | -4.09% | 1,249,692 | 1,280,000 | -2.37% |
| Lezhe | 3,533,696 | 3,510,000 | 0.68% | 1,337,674 | 1,180,000 | 13.36% | 2,149,643 | 2,240,000 | -4.03% |
| Sarande | 1,942,900 | 1,910,000 | 1.72% | 852,923 | 750,000 | 13.72% | 1,048,678 | 1,110,000 | -5.52% |
| Shkoder | 5,771,421 | 5,830,000 | -1.00% | 1,713,864 | 1,670,000 | 2.63% | 3,764,796 | 3,800,000 | -0.93% |
| Tirane | 88,097,485 | 88,500,000 | -0.45% | 53,716,268 | 54,155,000 | -0.81% | 32,145,908 | 31,645,000 | 1.58% |
| DTM | 94,359,636 | 93,960,000 | 0.43% | 66,563,394 | 67,669,000 | -1.63% | 19,719,940 | 18,991,000 | 3.84% |
| Vlore | 5,134,027 | 5,150,000 | -0.31% | 2,037,056 | 2,025,000 | 0.60% | 2,911,879 | 2,925,000 | -0.45% |
| **Total** | **246,576,742** | **247,013,000** | **-0.18%** | **143,401,879** | **144,113,000** | **-0.49%** | **88,778,080** | **87,900,000** | **1.00%** |

## Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 lekë )

| | Fakti TVSH | | Plan TVSH | | Ndryshimi % | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | neto | bruto | neto | bruto | neto | bruto |
| Berat | 264,817 | 543,249 | 181,000 | 581,000 | 86.71% | -6.5% |
| Diber | 525,282 | 598,265 | 508,000 | 588,000 | 46.43% | 1.7% |
| Durres | 1,218,926 | 2,381,474 | 760,000 | 2,260,000 | 32.47% | 5.4% |
| Elbasan | 277,118 | 898,583 | 317,000 | 917,000 | 326.24% | -2.0% |
| Fier | 500,626 | 1,459,409 | 3,004,000 | 4,204,000 | 104.94% | -65.3% |
| Gjirokaster | 320,091 | 403,867 | 290,000 | 420,000 | 20.84% | -3.8% |
| Korce | 521,997 | 771,003 | 500,000 | 800,000 | -0.35% | -3.6% |
| Kukes | 215,371 | 308,022 | 190,000 | 280,000 | -8.85% | 10.0% |
| Lezhe | 521,421 | 567,799 | 420,000 | 510,000 | 4.00% | 11.3% |
| Sarande | 349,363 | 390,663 | 368,000 | 418,000 | 34.24% | -6.5% |
| Shkoder | 327,110 | 619,871 | 340,000 | 700,000 | -4.04% | -11.4% |
| Tirane | 11,224,706 | 13,460,014 | 11,180,000 | 13,880,000 | -1.74% | -3.0% |
| DTM | 19,646,586 | 27,722,887 | 19,522,000 | 26,822,000 | 2.10% | 3.4% |
| Vlore | 593,714 | 778,806 | 580,000 | 780,000 | 14.13% | -0.2% |
| **Totali** | **36,507,129** | **50,903,912** | **38,160,000** | **53,160,000** | **4.17%** | **-4.2%** |

## Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 lekë )

| Tatimi mbi fitimin | | | |
|---|---|---|---|
| | Fakt | Plan | % |
| Berat | 286,815 | 290,000 | -1.10% |
| Diber | 490,231 | 510,000 | -3.88% |
| Durres | 1,898,331 | 1,810,000 | 4.88% |
| Elbasan | 531,331 | 600,000 | -11.44% |
| Fier | 829,367 | 850,000 | -2.43% |
| Gjirokaster | 219,454 | 210,000 | 4.50% |
| Korce | 500,395 | 460,000 | 8.78% |
| Kukes | 168,797 | 220,000 | -23.27% |
| Lezhe | 376,610 | 335,000 | 12.42% |
| Sarande | 207,683 | 155,000 | 33.99% |
| Shkoder | 557,579 | 478,000 | 16.65% |
| Tirane | 7,156,621 | 7,958,000 | -10.07% |
| DTM | 20,690,837 | 19,407,000 | 6.62% |
| Vlore | 499,911 | 540,000 | -7.42% |
| **Totali** | **34,413,962** | **33,823,000** | **1.75%** |

## Tabela 5. Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 lekë )

| | Fakt | Plan | % |
|---|---|---|---|
| Berat | 379,102 | 390,000 | -2.79% |
| Diber | 438,084 | 410,000 | 6.85% |
| Durres | 1,961,253 | 1,705,000 | 15.03% |
| Elbasan | 827,793 | 750,000 | 10.37% |
| Fier | 855,143 | 765,000 | 11.78% |
| Gjirokaster | 330,599 | 330,000 | 0.18% |
| Korce | 687,824 | 690,000 | -0.32% |
| Kukes | 251,106 | 265,000 | -5.24% |
| Lezhe | 410,078 | 400,000 | 2.52% |
| Sarande | 264,805 | 215,000 | 23.17% |
| Shkoder | 776,544 | 810,000 | -4.13% |
| Tirane | 13,808,762 | 13,300,000 | 3.83% |
| DTM | 14,859,720 | 16,040,000 | -7.36% |
| Vlore | 724,286 | 730,000 | -0.78% |
| **Totali** | **36,575,099** | **36,800,000** | **-0.61%** |

## Tabela 6. Krahasimi TAP sipas zërave (000 lekë )

| | | FAKT | PLANI | Diferenca PLAN - FAKT | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 2018 | 2018 | + ose - | Perqindje |
| | **Tatimi mbi te ardhurat personale** | **36,575,099** | **36,800,000** | **(224,901)** | **-0.61%** |
| **1** | Tatimi mbi page nga listepagesa | **20,955,857** | **21,560,000** | (604,143) | -2.80% |
| **1,1** | Nga te punesuarit e Sektorit Publik | 7,569,232 | 7,760,000 | (190,768) | -2.46% |
| **1,2** | Nga te punesuarit e Sektorit Privat | 13,386,625 | 13,800,000 | (413,375) | -3.00% |
| **2** | Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat | 2,090,648 | 2,540,000 | (449,353) | -17.69% |
| **3** | Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate | 3,876,027 | 4,300,000 | (423,973) | -9.86% |
| **4** | Tatim mbi Fituesit e Lodrave te Fatit | 89,498 | 90,000 | (503) | -0.56% |
| **5** | Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln lekë | 5,797 | 10,000 | (4,203) | -42.03% |
| **6** | Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim | 5,199,261 | 4,200,000 | 999,261 | 23.79% |
| **7** | Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet | 3,689,564 | 3,499,999 | 189,565 | 5.42% |
| **8** | Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesise Intelektuale | 271,595 | 350,000 | (78,405) | -22.40% |
| **9** | Tatimi mbi Deklaraten Individuale Vjetore te te ardhurave | 396,852 | 250,000 | 146,852 | 58.74% |

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 lekë )

| | Fakt | Plan | % |
|---|---|---|---|
| Berat | 57,631 | 56,000 | 2.91% |
| Diber | 182,443 | 79,000 | 130.94% |
| Durres | 142,196 | 117,000 | 21.54% |
| Elbasan | 86,152 | 89,000 | -3.20% |
| Fier | 359,799 | 77,000 | 367.27% |
| Gjirokaster | 59,654 | 71,000 | -15.98% |
| Korce | 72,670 | 98,000 | -25.85% |
| Kukes | 25,265 | 15,000 | 68.43% |
| Lezhe | 24,022 | 25,000 | -3.91% |
| Sarande | 11,220 | 12,000 | -6.50% |
| Shkoder | 38,591 | 42,000 | -8.12% |
| Tirane | 4,295,215 | 4,697,000 | -8.55% |
| DTM | 7,171,304 | 7,617,000 | -5.85% |
| Vlore | 127,975 | 85,000 | 50.56% |
| **Totali** | **12,654,138** | **13,080,000** | **-3.26%** |

## Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)

| Struk. | Lloji i te Ardhurave | FAKTET | | Diferenca | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2017 | 2018 | + ose - | Perqindje | |
| A | TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE | 12,418,438 | 12,654,138 | 235,700 | 1.90% | A |
| B | Tarifa Kombetare | 1,741,731 | 1,380,774 | (360,957) | -20.72% | B |
| C | Taksa Kombetare | 10,676,707 | 11,273,364 | 596,656 | 5.59% | C |
| | Tarifa "BUXHETORE" | 3,820,150 | 3,811,476 | (8,675) | -0.23% | |
| 1 | Tarife sherbimi per Qarkullimin e Automjeteve te Huaja | 97,106 | 89,872 | (7,234) | -7.45% | 1 |
| 2 | Tarife per rregjistrimin e Lojerave te Fatit , Llotarive , | 34,957 | 40,122 | 5,165 | 14.77% | 2 |
| 3 | Tarife sherbimi per licensat radiotelevizive | 21,348 | 16,587 | (4,761) | -22.30% | 3 |
| 4 | Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve televizive | 1,188,660 | 1,203,624 | 14,964 | 1.26% | 4 |
| 5 | Tarife sherbimi per sherbimet e radiokomunikacionit | 492,431 | 439,233 | (53,198) | -10.80% | 5 |
| 6 | Takse nacionale per lejen e ushtrimit te veprimtarise se peshkimit | 20,043 | 19,562 | (481) | -2.40% | 6 |
| 7 | Takse nacionale e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin | 2,095,154 | 2,368,155 | 273,001 | 13.03% | 7 |
| 8 | Takse nacionale per ambalazhet plastike te lengjeve te ambalazhuara (shishe, bidona etj) | 1,760,099 | 1,755,029 | (5,070) | -0.29% | 8 |
| 9 | Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit shteteror nga persona juridike tregtare dhe ndermarje shteterore | 45,023 | 27,422 | (17,601) | -39.09% | 9 |
| 10 | Taksë mbi Primet e shkruara | 337,897 | 865,569 | 527,673 | 0.00% | 10 |
| 11 | Taksa per regjistrim fillestar per automjete luksoze | 42,613 | 125,012 | 82,398 | 0.00% | 11 |
| 12 | Taksa e pervitshme per automjetet luksoze | 99,612 | 216,980 | 117,368 | 0.00% | 12 |
| 13 | Takse per automjetet e perdorura te transportit | 4,244,722 | 4,023,232 | (221,490) | -5.22% | 13 |
| 14 | Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me avion | 1,585,749 | 1,690,673 | 104,924 | 6.62% | 14 |
| 15 | Taksa portuale | 846 | 834 | (12) | -1.42% | 15 |
| 16 | Taksa e Akteve dhe e Pulles | 254,995 | 227,754 | (27,241) | -10.68% | 16 |
| 17 | Taksa e rentes minerare | 1,568,171 | 1,273,792 | (294,379) | -18.77% | 17 |
| 18 | Tarife per Sherbimet Konsullore | 292,920 | 221,271 | (71,648) | -24.46% | 18 |
| 19 | Tarife Per paisjen me Deshmi Aftesie per Drejtim Automjeti | 260,391 | 256,675 | (3,716) | -1.43% | 19 |
| 20 | Tarife per Regjitrim ne arsimin e Larte | 943,024 | 522,053 | (420,971) | -44.64% | 20 |
| 21 | Tarifa per pasaporte lundrimi te personave | 1,972 | 1,886 | (86) | -4.37% | 21 |
| 22 | Tarifa per aktet administrative | 639,604 | 702,434 | 62,830 | 9.82% | 22 |
| 23 | Tarife , gjoba, interesa | 3,720 | 7,820 | 4,100 | 110.23% | 23 |
| 24 | Taksa te tjera , gjoba, interesa | 207,531 | 370,023 | 162,491 | 78.30% | 24 |
| A+C | Gjithesej Taksa , tarifa nacionale + tarifa buxhetore | 16,238,589 | 16,465,613 | 227,025 | 1.40% | A+C |

## Tabela 9. Të ardhurat nga Taksa e Qarkurllimit dhe Karburantit (000 lekë )

| | Fakt | Plan | % |
|---|---|---|---|
| Berat | 0 | 0 | 0.00% |
| Diber | 0 | 0 | 0.00% |
| Durres | 0 | 0 | 0.00% |
| Elbasan | 0 | 0 | 0.00% |
| Fier | 1,523,304 | 0 | 0.00% |
| Gjirokaster | 0 | 0 | 0.00% |
| Korce | 0 | 0 | 0.00% |
| Kukes | 0 | 0 | 0.00% |
| Lezhe | 0 | 0 | 0.00% |
| Sarande | 0 | 0 | 0.00% |
| Shkoder | 0 | 0 | 0.00% |
| Tirane | 16,801,271 | 16,450,000 | 2% |
| DTM | 0 | 0 | #DIV/0! |
| Vlore | 0 | 0 | 0% |
| **Totali** | **18,347,259** | **16,450,000** | **11.53%** |

## Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore

| | Fakt | Plan | % |
|---|---|---|---|
| Berat | 2,183,134 | 2,250,000 | -2.97% |
| Diber | 1,900,183 | 1,950,000 | -2.55% |
| Durres | 7,949,239 | 7,858,000 | 1.16% |
| Elbasan | 3,951,136 | 4,000,000 | -1.22% |
| Fier | 4,727,471 | 4,650,000 | 1.67% |
| Gjirokaster | 1,668,219 | 1,749,000 | -4.62% |
| Korce | 3,408,160 | 3,452,000 | -1.27% |
| Kukes | 1,249,692 | 1,280,000 | -2.37% |
| Lezhe | 2,149,643 | 2,240,000 | -4.03% |
| Sarande | 1,048,678 | 1,110,000 | -5.52% |
| Shkoder | 3,764,796 | 3,800,000 | -0.93% |
| Tirane | 32,145,908 | 31,645,000 | 1.58% |
| DTM | 19,719,940 | 18,991,000 | 3.84% |
| Vlore | 2,911,879 | 2,925,000 | -0.45% |
| **Totali** | **88,778,080** | **87,900,000** | **1.00%** |

## III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE

Gjatë 12-mujorit 2018, puna e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve, është përqendruar në konsolidimin, rritjen e nivelit dhe lehtësimin e shërbimit ndaj tatimpaguesve. Kjo është arritur duke ndjekur realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara, në Planin Operacional të Vitit 2018, si edhe detyrave të realizuara në funksion të reformave të DPT-së.

**Asistenca dhe shërbimi për tatimpaguesit**

Rezultatet e punës së Sektorit të Asistencës dhe Shërbimit, për Vitin 2018 janë pjesë përbërëse e perfomancës së Drejtorisë së Shërbimit për tatimpaguesit në DPT. Puna e këtij Sektori, është përqëndruar në zbatimin e detyrave të caktuara në Planin Operacional 2018, si edhe detyrave të ngarkuara në funksion të reformave të ndërmarra nga DPT.

Më konkretisht puna e kryer gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018 është fokusuar në:

**1. <u>Shërbim dhe asistencë cilësore për tatimpaguesit</u>**

Shërbimi për tatimpaguesit është orientuar drejt përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së tyre. Në çdo zyrë apo sportel të Shërbimit për tatimpaguesit, ku janë pritur më shumë se 202.000 individë, tatimpaguesve të interesuar iu është ofruar shërbim cilësor dhe asistencë për kërkesat që ata kanë paraqitur: në vizitat ballë për ballë, emaile të dërguar, telefonata etj. në lidhje me plotësimin e detyrimeve tatimore, ndryshimet e Legjislacionit tatimor, pajisjen me vërtetime etj.

Numri i vërtetimeve të lëshuara në sportele gjatë vitit 2018 është 38.804, shifër e cila përbën 16% të vërtetimeve të lëshuara gjatë vitit 2017, ndërkohë që rreth 400.000 vërtetime janë lëshuar nëpërmjet e-albania (portal + moduli për punonjësit qeveritarë), në të cilin ofrohen 9 shërbime të DPT, pra 9 prej vërtetimeve.

## Tabela 11. Përshkrimi i kontakteve dhe shërbimeve të ofruara 2018

| | |
|---|---|
| **Numri i njoftimeve** i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar. | **131 474** |
| **Numri i takimeve të mbajtura** me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar. | **9 645** |
| **Numri total i vizitave këshilluese** të përfunduara | **41 768** |
| **Numri i seminareve edukues** të realizuar | **118** |
| **Numri total i taksapaguesve të asistuar ( ballë për ballë )** | **202 131** |

## Tabela 12. Përshkrimi i vërtetimeve të lëshuara nga funksioni i shërbimit

| **Vërtetime të lëshuara në sportel** | | |
|---|---|---|
| **nr** | **Emërtimi I Vërtetimit** | **Viti 2018** |
| 1 | Vërtetim për posedim mjetesh | **1,656** |
| 2 | Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesit Formulari E-SIG 02a | **1,569** |
| 3 | Vërtetim për të ardhurat e realizuara në tre vitet e fundit për tender | **1,977** |
| 4 | Vërtetim për individë të paregjistruar | **18,987** |
| 5 | Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për individët Formulari E-SIG03a | **7,412** |
| 6 | Vërtetim për përgjegjësinë tatimore | **1,138** |
| 7 | Vërtetim për pagimin e detyrimeve | **4,893** |
| 8 | Vërtetim për statusin e tatimpaguesit | **1,172** |
| 9 | Vërtetim për regjistrimin e investitorit tek Drejtoria Rajonale | |
| | **Totali** | **38,804** |

## Tabela 13. Vërtetime të lëshuara nëpërmjet Portalit e-albania

| **nr** | **Emertimi I vertetimit** | **Viti 2018** |
|---|---|---|
| 1 | Vërtetim për pagim detyrimesh | **49,735** |
| 2 | Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti | **22,262** |
| 3 | Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin | **234,960** |
| 4 | Vërtetim për përgjegjësitë tatimore | **8,697** |
| 5 | Vërtetim për regjistrim të investitorit | **454** |
| 6 | Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën) | **14,950** |
| 7 | Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit | **34,411** |
| 8 | Kërkesë për vërtetim për posedim mjeti | **1,296** |
| 9 | Kërkesë për vërtetim për individ të paregjistruar | **33,106** |
| | **Totali** | **399,871** |

## 2. <u>Informimi dhe edukimi i tatimpaguesve:</u>

- **Në faqen e internetit të Administratës Tatimore** [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al) : janë publikuar mbi 260 njoftime për ndryshimet ligjore, afatet e deklarimit, risi të Administratës tatimore, thirrje për përditësim të dhënash etj, si dhe njoftime informuese ne Facebook. Ndërkohë në llogarinë e deklarimit elektronik të tatimpaguesit e-filing, janë shfaqur 9 njoftime për: ndryshimet ligjore, përditësimin e të dhënave, kujtesë për afatet e deklarimit etj.

Gjithashtu është krijuar Platforma e informimit, në të cilën është publikuar një set prej 11 materialesh informuese (broshura dhe video) për tatimpaguesit sipas kategorive dhe fashave të qarkullimit. Ky set është prodhuar në një sasi prej 72.000 copë broshura dhe fletëpalosje, të cilat janë shpërndarë në çdo DRT.







**Informimi i tatimpaguesve për ndryshimet ligjore**: është realizuar përditësimi dhe publikimi i ndryshimeve të Legjislacionit Tatimor në ëeb, po ashtu edhe njoftimeve informuese në ëeb dhe Facebook.

Gjatë vitit 2018, nga punonjësit e Shërbimit për tatimpaguesit janë kryer mbi 47.000 **vizita informuese** në mjediset e ushtrimit të aktivitetit të tatimpaguesve, me qëllim informimin dhe sensibilizimin e tyre për plotësimin e detyrimeve tatimore.

Gjatë muajit Dhjetor 2018, u hartua Plani i Komunikimit për prezantimin e Paketës fiskale 2019, në të cilin u përfshinë aktivitetet për periudhën janar-shkurt 2019 për informimin e tatimpaguesve dhe të publikut.

**Fushata për informimin e biznesit të vogël BV, i cili u përfshi për herë të parë në skemën e TVSH-së.**

- Në çdo DRT u ngrit Këndi i asistencës (13 Kënde), dedikuar BV, në të cilin u asistuan mbi 7.000 subjekte nga rreth 10.000 që u përfshinë prej datës 1 prill në skemën e TVSH-së.
- U zhvilluan rreth 100 trajnime, për periudhën mars – korrik, në të cilat morën pjesë mbi 1.600 përfaqësues të 4.100 subjekteve BV.
- U zhvilluan mbi 13.000 vizita informuese në terren, në vendin e ushtrimit të aktivitetit të të gjithë tatimpaguesve të përfshirë në skemë.
- U krijua në ëeb, Menu e dedikuar Këndi i Biznesit të vogël https://www.tatime.gov.al/c/8/299/kendi-i-biznesit-te-vogel, në të cilin u publikuan materialet informuese të përgatitura për këtë qëllim (kalendari i trajnimeve, kalendari tatimor, njoftime, materiale informuese, veprimet që duhen ndjekur, mënyra e deklarimit dhe pagesës, Pyetje – Përgjigje etj, si dhe 4 video ilustruese për mënyrën e deklarimit të Inventarit, librave të shitjes dhe blerjes, deklaratës së TVSh-së)
- U përgatit Fletëpalosja për Biznesin e vogël me TVSH, 10.000 kopje, që u shpërndanë në çdo DRT dhe në ËEB.
- Deklarata e Thjeshtuar e TVSH për Biznesin e Vogël për të krijuar lehtësi në plotësimin e saj nga BV.

***Niveli i deklarimit nga subjektet e përfshira për herë të parë në skemën e TVSH-së, në përfundim të afatit të deklarimit për çdo 3 mujor rezultoi mjaft i sukseshëm dhe me një rezultat surprizë deklarimi në mbi 95%.***




**Fushata informuese për subjektet që operojnë në fushën e turizmit përfshiu periudhën maj – shtator 2018 dhe u përqëndrua në këto drejtime:**

- Ftesë e personalizuar nga DRT-të për përmirësim të vetdeklarimit për 2.568 tatimpagues
- Thirrje për korrektesë në zbatimin e legjislacionit tatimor për 4.066 tatimpagues
- 22 kronika në emisione lajmesh, 51 njoftime të publikuara në ëeb dhe 53 njoftime në FB, 11 takime me shoqatat e operatoreve turistikë, 1615 tatimpagues të kontaktuar nga Call Center.

**3. <u>Sigurimi i shërbimit cilësor e profesional si edhe i kushteve të përshtatshme për komunikimin me tatimpaguesit.</u>**

- Me qëllim rritjen profesionale të punonjësve të Shërbimit për tatimpaguesit, janë realizuar trajnime në lidhje me ndryshimet ligjore si dhe për Manualin e Shërbimit.

- Është realizuar standartizimi i sporteleve të shërbimit sipas përshkrimeve të 16 Quick-ëins (kritereve të standartizuara për ofrimin e shërbimeve publike), në çdo DRT, si dhe janë rikonstruktuar qendrat e Shërbimit për tatimpaguesit në Tiranë, Fier, Kukës.




**4. <u>Qendra e Thirrjeve</u>**

Qëndra e Thirrjeve në zbatim të Planit Strategjik të Administratës Tatimore 2017 – 2021 dhe të Planit Operacional për vitin 2018 ka përmbushur objektivat si më poshtë:

1. Garantimi i komunikimit me tatimpaguesit për përmbushjen vullnetare

1.1 Implementimi dhe vënia në funksionim me efiçensë të plotë e sistemit të komunikimit GoAutoDial.

1.2 Gjatë vitit 2018 janë realizuar 9,021 thirrje hyrese, 45,367 thirrje dalse dhe 5,757 komunikime nëpërmjet Live- chat.

1.3 Gjatë vitit 2018 janë realizuar 36 fushata sipas tematikës së mëposhtme:

- 1 fushatë për motransmetues të pajisjeve fiskale.

- 10 fushata për tatimpagues debitorë të TVSH-së.

- 1 fushatë për Turizmin.

- 11 fushata për tatimpagues debitorë në Kontributet e Sigurimeve.

- 11 fushata për tatimpagues debitorë në Tatimin në burim.

- 1 fushatë për tatimpagues pasivë që kishin kryer blerje.

- 1 fushatë informuese për tatimpagues të Biznesit të Vogël që përfshihen në skemën e TVSH-së.

1.4 Duke filluar nga data 1 Prill 2018 ju është ofruar tatimpaguesve shërbimi i informimit të situatës së tyre të borxhit tatimor në kohë reale. Gjatë vitit 2018 këtë shërbim e kanë përfituar 582 tatimpagues që kanë telefonuar pranë Qendrës së Thirrjeve.

1.5 Dërgimi i rreth 23 çështjeve që janë referuar në ndihmë të tatimpaguesve në Help Desk apo Drejtori të ndryshme në DPT.

1.6 Jane kryer 3 fushata lidhur me informimin e Biznesit të Vogël që do të përfshihen në skemën e TVSH. 927 tatimpagues janë asisituar nga QTH për hapat që duhet të ndiqen për regjistrim në Tvsh. 3,558 prej tyre janë informuar për sesionet trajnuese.

2. Implementimi dhe zbatimi i drejtë i legjislacionit tatimor që lidhet me komunikimin e ATQ me tatimpaguesit.

2.1 Implementimi dhe përdorimi i Raporteve të menaxhimit mbështetur në sistemin elektronik GoAutoDial.

2.2 Gjatë vitit 2018 kemi kryer 8 njoftime për tatimpaguesit nëpërmjet faqes Ëeb të DPT si dhe 3 kronika televizive për funksionet e Qendërs së Thirrjeve. Gjithashtu kemi marrë pjesë në 2 studio televizive me temë diskutimi mbi funksionet e Qendrës së Thirrjeve.

3. Progresi organizativ i ATQ zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

3.1 Janë përmirësuar 5 indikatorë cilësorë të performancës.

3.2 Referuar kërkesës së dërguar nga Drejtoria QTH për plotësim stafi, kemi patur të komanduar punonjës me kontrate 6-mujorin e parë të vitit 2018.

3.3 Raportim pranë Komiteteve funksionale në DPT gjatë mbledhjeve periodike në vitin 2018.

# IV. KONTROLLI TATIMOR

Gjatë vitit 2018, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara dhe miratuara, punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performacës së administratës tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore.

Realizimet e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij, si dhe në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, kanë konsistuar në drejtimet e mëposhtme:

1. Në përmirësimin dhe rritjen e kontaktit me anë të adresës elektronike apo takime me tatimpaguesin për stimulimin për ndryshime vullnetare të deklaratave. Plotësim në kohë dhe me lehtësi të deklaratave dhe formularëve. Lehtësimi i procedurave dhe kërkesave administrative për tatimpaguesit e Administratës Tatimore, duke marrë në konsideratë ndër të tjera madhësinë e tyre si dhe thjeshtëzimin e deklaratave dhe formularëve, evidentimi i problematikave dhe nxjerrja e rezultateve. Lehtësimi i procesit për tatimpagues të cilët jo qëllimisht bëjnë gabime.

   Për të rritur pajtueshmërinë vullnetare të tatimpaguesve u inicua ndërgjegjësimi dhe kontrolli i subjekteve me aktivitet në fushën e ndërtimit dhe karburantit, të cilët u identifikuan si potencialisht me risk, nisur nga deklarimi në ulje i qarkullimit.
2. Si Plan Sektorial gjatë vitit 2018, u hartua dhe u monitorua Plani Sektorial i Turizmit, me qëllimin e administratës tatimore për rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e lidhjeve me tatimpaguesin, për njoftime të vazhdueshme për stimulimin e përmbushjes vullnetare të deklarimit të të ardhurave tatimore. Në këtë kuadër u kryen analiza dhe u bë perzgjedhja e subjekteve me risk nga DMR. Mbi bazën e këtij risku Drejtoria e Kontrollit në DPT hartoi planin për çdo DRT në lidhje me këta sektorë.
3. Në bazë të objektivit strategjik gjatë vitit 2018, Administrata Tatimore ka synuar që bazuar në planin e kontrolleve të evidentohen pyetjet kryesore, të cilat do të shërbejnë për përditësim të vazhdueshëm të infomaciaonit në faqen e Administratës Tatimore në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë te deklarimeve dhe pagesave. Lidhur me këtë administrata tatimore nga pyetësorët ka grumbulluar dhe evidentuar informacionin e nevojshëm për tatimpaguesit, të cilat janë publikuar në faqen e internetit të Administratës Tatimore si më poshtë:

- ✓ Udhëzime dhe ftesë për marrjen pjesë në trajnimet që u zhvilluan në çdo drejtori rajonale tatimore, lidhur me përfshirjen e bisnesit të vogël në skemën e TVSH –së.
- ✓ Njoftim për zbatimin e procedurave të dorëzimit elektronik të pasqyrave financiare të vitit 2017
- ✓ Njoftim me qëllim përmbushjen me korrektësi të detyrimeve, siç është plotësimi dhe dorëzimi i librave të shitjes dhe blerjes dhe deklaratën e thjeshtuar të TVSH-së për tatimpaguesit e Biznesit të vogël .
- ✓ Njoftim për deklarata dhe afatet e Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave për vitin 2017.
- ✓ Njoftim për informim të tatimpaguesve aktiviteti i të cilëve ushtrohet në fushën e strukturave akomoduese dhe që përfiton nga shkalla tatimore 6 % TVSH me aktivitetin tjetër që ushtrohet me shkallë standarde të TVSH-së.
- ✓ Njoftim për afatin e deklarimit dhe të pagesës së dividentit.
- ✓ U njoftuan tatimpaguesit për publikimin e ligjit nr.39/2018, datë 09.07.2018 – Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.
- ✓ U publikua udhëzimi i përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”
- ✓ Njoftim për tatimpaguesit të cilët ende nuk janë subjekt i pagesës së Tatimit mbi Qiranë, për përmbushje të detyrimit sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ Informimi për ata tatimpagues, të cilët nga monitorimi i vazhdueshëm kanë shfaqur pasaktësi në deklarimet e tyre , që të vetëkorrigjojnë të dhënat e pasakta.
- ✓ Njoftim për përmbushje të Detyrimit të tatimpaguesve për të dhënë informacion administratës tatimore”, lidhur me inventarin analitik të datës 31.12.2018.

Sipas planit në vitin 2018 është bërë evidentimi i tatimpaguesve më problematikë dhe ndjekja e tyre për sistemim të situatës dhe tatimpagues të veçantë të konsideruar me risk dhe korigjimi i situatës së tyre tatimore.

Gjatë vitit 2018, përveç se ka vijuar puna me analizën e raporteve të krahasimit të të dhënave me doganën apo dhe kryqëzimi i librave të shitjes dhe blerjes në sistemin C@TS për subjektet aktive, është insistuar dhe në kontrollin e statusit të subjektit për periudhën e kryerjes së transaksioneve shitje blerje apo importe. Pas identifikimit të rasteve, kur subjekti ka rezultuar me status Pasiv, mbështetur në verifikimet e kryera në të gjitha raportet e analizuara, nga ana e çdo DRT-je janë marrë masa konkrete për sistemime apo rivlerësime përkatëse në rast shkeljeje ligjore.

## I. Përzgjedhja për Kontroll

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 80, Kontrolli Tatimor, është hartuar dhe Manuali I Kontrollit Tatimor, sipas të cilit përcaktohet dhe përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll dhe plani mujor i tyre.

Përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riksut pasi ka bërë seleksionimin e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me risk sipas modulit të Riskut.

## II. Rezultatet e kontrolleve sipas DRT

Lidhur me rezultatet e kontrolleve tatimore të realizuara gjatë periudhës 12 mujore Janar- Dhjetor 2018, nga 2253 kontrolle të planifikuara , kanë përfunduar 1988 kontrolle për të cilat treguesit e realizuar janë si më poshtë:

- **10,59 Mld** janë gjetjet në total për vitin 2018
- **5.3 Mln** është vlera mesatare e gjetjeve
- **117%** janë rritur gjetjet nga Kontrolli I TP të përzgjedhur nga Moduli I Riskut Vs 2017
- 32% janë rritur gjetjet nga Kontrolli I TP nga propozimet e DRT-ve Vs 2017

## III. Plane Sektoriale dhe detyra të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit

Gjatë 2018 AT u angazhua në zhvillimin e Planit Sektorial të Turizmit .

Në themel të tij ishte përpunimi i një strategjie veprimesh me tatimpaguesit, që operojnë në këtë sektor në lidhje me detyrimet tatimore, ofrimin e asistencës së duhur për çdo kërkesë të tyre, ndërgjegjësimin e publikut për të tërhequr në çdo kohë kuponin tatimor, uljen e evazionit fiskal, rritjen e të ardhurave, si edhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Rezultatet e ketij plani janë të përmbledhura si më poshtë:

**Plani Sektorial i Turizmit**

- **1,500 tatimpagues** janë intervistuar nga Drejtoritë Rajonale
- **72% e tatimpaguesve** kanë reguar pozitivisht për rritje të përmbushjes vullnetare
- **13%** është rritur **numri i punonjësve** në sektorin e turizmit krahasuar me sezonin e kaluar
- **12%** është rritur qarkullimi me TVSH në Sektorin e Turizmit
- **13 %** është rritur TVSH e pagueshme

Lidhur me rezultatet e vizitave fiskale të realizuara gjatë periudhës 3 mujore shtator-nentor 2018, 64% e planit për subjektet me aktivitet ndërtime si edhe 70% për subjektet me aktivitet karburant për të cilat treguesit e realizuar janë si më poshtë:

- ✓ **227 tatimpagues me aktivitet ndërtimi kanë vetëkorigjuar detyrimin për t'u paguar dhe 105 prej tyre kanë qenë objekt rivlerësimi nga Drejtoria e Kontrollit nga Zyra.**
  - ➢ **179.2 mln ose 83% është vlera e paguar së bashku me uljen e gjendjes kreditore për rivleresimet e kryera nga vetë tatimpaguesi /inspektori.**
- ✓ **65 tatimpagues me aktivitet në fushën e karburanteve kanë vetëkorigjuar detyrimin për t'u paguar dhe 187 prej tyre kanë qenë objekt rivlerësimi nga Drejtoria e Kontrollit nga Zyra.**
  - ➢ **12.1 mln ose 84% është vlera e paguar së bashku me uljen e gjendjes kreditore për rivleresimet e kryera nga vetë tatimpaguesi / inspektori.**

**Detyra të ndjekura nga Drejtoria e Kontrollit**

Përveç Planit sektorial, kontrolleve tematike, vizitave fiskale, Drejtoria e Kontrollit ka vijuar punën me detyra konkrete lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ka arritur rezultate si më poshtë vijon:

- Eshtë ulur gjendja kreditore me anë të sistemimeve të rubrikave të parregullta të TVSH në vlerën 440 Mln, si pasojë e deklarimeve të blerjeve dhe parapagesave
- Pas Verifikimit të Tatimpaguesve Mosdeklarues të Tatim Fitimit për vitet 2016 dhe 2017, është ulur vlera e Debisë 609,8 Mln nga vlerësimet automatike të TF për vitet 2016 dhe 2017
- Pas verifikimit të deklarimit individual të të ardhurave (DIVA), për vitet 2015, 2016 dhe 2017 , jane sistemuar deklarimet e pasakta duke ulur vlerën e Debisë në 293,9 mln.
- 2014 Tatimpaguesve u është ndryshuar përgjegjësia tatimore nga TFTH në TF.
- 3149 Tatimpagues janë regjistruar në përgjegjësinë e Tatimit në Burim
- 1491 Tatimpagues të regjistruar që deklaronin me zero, kanë ndryshuar deklaraten me pagesë, pas verifikimit, vlerësimit dhe llogaritjes së tatimit në burim për ambientet e dhëna me qira për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar,.

**Urdhëresat e dala gjatë periudhës janar – dhjetor 2018**

- Nr. Prot. 3048, datë 12.02.2018, Urdhëresë për regullshmerinë dhe zbatimin e kërkesave ligjore në kontrollet tatimore për rimbursimin e TVSH-së

- Nr. Prot. 3319/1 , datë 28.02.2018, Mbi disa problematika të dala nga proçesi i transferimit dhe ndërveprimit të të dhënave të import-eksport ndërmjet DPD dhe DPT
- Nr. Prot. 7988, datë 18.04.2018, Urdhëri 25, datë 18.04.2018, për plotësimin e të dhënave të tatimpaguesve që ushtrojnë veprimtari në zonat turistike me qëllim hartimin e planit të masave për sezonin turistik
- Nr. Prot. 9707, datë 10.05.2018, Për zbatimin e kërkesave ligjore në kontrollet tatimore për rimbursimin e TVSH-së
- Për rivlerësimin e individëve që konstatohen nga burime të ndryshme që nuk kanë deklaruar të ardhurat kemi dërguar Rregulloren Nr.24607 datë 24.102017 me shkresën Nr13752 datë 03.07.2018.
- Me shkresën Nr 15577 datë 03.08.2018 kemi hartuar dhe dërguar Urdhëresën Nr.15577 datë 30.07.30.07.2018 "Mbi mënyrën e veprimit të administratës tatimore, me tatimpaguesit që pengojnë kontrollin, ose nuk gjenden në adresat e deklaruara“
- Me shkresën Nr 21594 datë 23.10.2018 kemi dërguar detyrat për zbatim për kontrollet që ëkryhen per rimbursimin e TVSH-së për grumbulluesit nga fermerët dhe për regjimin e përpunimit aktiv(fasone)
- **Hartimi i Manualit te Kontrollit nga zyra** sipas Komitetit Operacional Nr. 13 - Në manual është përcaktuar se ndarja e punës së inspektorëve të bëhet sipas llojit të biznesit. Në këtë menyrë inspektorët më me përvojë të mbikqyrin biznesin e madh. Në manual është parashikuar një kalendar i punëve, i ndarë sipas muajve, për të qënë me konkretë dhe më të qartë dhe për t’i dhënë përparësi çështjeve kryesore sipas periudhave tatimore
- Është perfunduar kontrolli nga Drejtoria e Kontrollit në DPT në 7 Drejtori Rajonale
- Janë zhvilluar takime mujore me DK në DRT mbi progresin dhe statusin e detyrave në ndjekje.

# V. MENAXHIMI I RISKUT

**A. Realizimi i prioriteteve:**

i. DMR ka përfunduar Regjistrin e Riskut i cili është miratuar nga Komiteti i Përmbushjes në prill 2018.

ii. Rifreskimi i kodeve të aktiviteteve ekonomike.

Për arritjen e këtij objektivi DPT kërkoi dhe arriti bashkëpunim me insitucionet e QKB, e cila administron këto të dhëna në regjistrat e saj elektronike, si edhe me INSTAT, e cili disponononte të dhëna të vrojtuara në terren. Në përfundim të këtij procesi u arrit që gjithë tatimpaguesit u pajisën me kodin REV-2.

iii. Mbi zgjerimin e aksesit që DPT duhet të ketë në të dhënat e të tretëve, DMR në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK ka filluar komunikimin me AKSHI për të bërë të mundur fillimisht, evidentimin e informacionit nga institucione që ekspozojnë të dhëna në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

iv. Lidhur me trainimin e vazhdueshëm të stafit të Drejtorisë së Menxhimit të Riskut.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer trajnime nga: INSTAT për kodet e aktiviteteve ekonomike; nga OECD mbi procesin e menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë, strategjitë për përmirësimin e pajtueshmërisë në sektorin e SME-ve dhe reduktimin e mos-pajtueshmërisë (duke përfshirë ekonominë informale); nga FMN (gjithë stafi) mbi analizat sektoriale dhe identifikimin e grupeve të riskut.

**DMR ka rritur përpjekjet për sistematizimin e menaxhimit të riskut.**

Në këtë aspekt në funksion të arritjes së objektivave strategjike të DPT, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut ka ndërmarrë një sërë veprimesh për identifikimin e risqeve të cilat përveç mjetit kryesor që ajo ka patur në dispozicion (modulit të riskut) kanë përfshirë dhe një sërë analizash mbi lloje të ndryshme tatimesh për të siguruar një pamje të plotë dhe gjithëpërfshirëse të situatave aktuale.

DMR mbështetur në të dhënat e siguruara kryesisht nga deklarimet ka ndërtuar analiza të cilat kanë patur edhe karakter periodik, përmbledhje të të cilave shkurtimisht paraqiten si më poshtë:

Nga Analiza sektoriale e kryer bazuar mbi të dhënat e modulit të riskut u identifikuan si sektorë me risk sektori i tregëtisë, ndërtimit, shërbimeve profesionale të bisnesit, minierat&guroret dhe turizmit.

Miratimi i saj nga Komiteti i Përmbushjes u bë me vendimin nr.16 datë 30.05.2018 i cili zgjodhi për zbatim sektorin e Hoteleri Turizmit mbi të cilin i ndërtua dhe plani operacional i detajuar.

Grafiku i mëposhtëm ilustron pjesën që zënë në shmangien ndaj pajtueshmërisë këta sektorë të vlerësuar si më me risk potencial në ekonominë kombëtare, për periudhën Shkurt 2017 – Janar 2018



## Analiza e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

**Analiza për TVSH-në, pavarësisht rritjes progressive të TVSH së arketuar, u evidentuan një sërë faktorësh me risk që kanë ndikim në uljen e pagesës së TVSh-së dhe në mospërmbushjen tatimore. Këta faktorë u analizuan në mënyrë periodike dhe u krahasuan me të njejtën**




## Analiza e Tatimit mbi Fitimin

**Analiza për Tatim mbi Fitimin 2016/2017 ku u analizuan të dhënat nga vetdeklarimi dhe faktorët me risk që ndikojnë në mospërmbushjen tatimore. U analizua trendi për ccdo DRT dhe tatimpaguesit me ndikimin negativ dhe që përbënin risk të lartë.**



# Analiza mbi Tatimit mbi Lojrat e Fatit

**Analiza për tatimin mbi lojërat e fatit u përqendrua në një pamje më të gjerë të të gjithë kornizës ku zhvillohej ky aktivitet duke përfshirë aspektin ligjor, si dhe analizën e detajuar të treguesve të deklarimit, evidentimin e strukturave të përfshira. U evidentua faktori imediati i Riskut që ishte ndryshimi në mënyrën e deklarimit por edhe nënraportimi i tatimpaguesve. Nuk u ndermor asnjë hap më tej sepse me inisiativën e Qeverisë Shqiptare u miratua në parlament Ligji për ndalimin e lojrave të fatit.**

**C. Veprimtari të tjera**

I. Ndjekja periodikisht (çdo muaj) i plotësimit të kushteve për regjistrimin, me përgjegjësinë tatimore për TVSH-në të tatimpaguesve nën regjimin e biznesit të vogël, duke kontrolluar raportimin e kasave fiskale. Për këtë qëllim është hartuar një miniplan operacional ku janë përcaktuar strukturat përgjegjëse, veprimet e ndërmara, afatet kohore dhe rezultatet e pritshme. Procesi ka synuar sistematizimin e veprimeve nga administrata tatimore dhe uljen e risqeve të regjistrimit.

II. Ndjekja e indikatorëve të përmbushjes: DMR mbledh dhe përditëson të dhënat lidhur me përmbushjen tatimore. Këto indikatorë i referohen regjistrimit, deklarimit në kohë, pagesës në kohë dhe raportimit të saktë. Të dhënat janë ndërtuar për llojet kryesore të tatimeve.

III. Identifikimi i risqeve duke përdorur modulin e kontrollit ka shërbyer në të kaluarën vetëm për qëllim të përzgjedhjes së tatimpaguesve për kontroll të thelluar tatimor. Duke qenë se burimet në dispozicion të DPT janë të kufizuara, synimi i saj është identifikimi i atyre risqeve, të cilat DPT mund t'i trajtojë pa humbur kohë. Në këtë drejtim DMR analizoi gjithë rregullat e Riskut dhe përzgjodhi ato të cilat evidentojnë shkelje pothuajse të provuara të ligjit. Kjo qasje e re mori miratimin e Komitetit të Përmbushjes nëpërmjet Vendimit nr.19 datë 15.10.2018. Në vijim të këtij procesi u ndërtua plani i veprimeve duke detajuar strukturat përgjegjëse, veprimet që duheshin kryer, afatet, rezultatet dhe kohën e raportimit. Në varësi të llojit të rregullave të thyera për trajtimin e tyre u menduan dy mënyra veprimi; të komunikohej me tatimpaguesin, për ato rregulla që linin vend për verifikime të mëtejshme (6 rregulla), dhe nxitja e tij për të rregulluar vetëdeklarimin. Strukturat përgjegjëse ishin Shërbimi i Tatimpaguesve dhe Qendra e Thirrjeve. U hartua nga DMR përmbajtja e tekstit të komunikimit dhe iu dorëzua për veprim strukturave të sipërpërmendura. Për grupin e mbetur me 3 rregulla, mënyra e veprimit e menduar

ishte komunikim me tatimpaguesin dhe kryerja e vlerësimeve tatimore nga strukturat e kontrollit në zyra pranë DRT-ve. I gjithë procesi është në vijim dhe në monitorim nga DPT.

IV. Në funksion të veprimit si një e tërë, çdo drejtori në DPT shkëmben informacion me drejtoritë e tjera. Në këtë kuadër DMR mbi bazën e të dhënave të siguruara nga Sektori i kasave fiskale, evidentoi tatimpaguesit me rënie të ndjeshme të qarkullimit të raportuar me kasë, të cilët shfaqin risk të lartë lidhur me mosraportimin e saktë të të ardhurave dhe në vijim të mënyrës së veprimit të ndërmarrë dhe më parë prej tyre, vijoi me hartimin e një miniplani operacional duke ngarkuar DRT-të dhe Qendrën e Thirrjeve për veprime të mëtejshme në fillesë të të cilave qëndronte komunikimi.

V. Monitorimi i vazhdueshëm i rregullave të Riskut; Gjatë kësaj periudhe DPT ka shtuar numrin e rregullave që përdoren nga Moduli i Riskut që aktualisht janë 50. E rëndësishme të përmendet, është implementimi dhe përdorimi i rregullave që kanë të bëjnë me kryqëzimin e faturave në librat e blerjeve dhe shitjeve. Kjo ka lejuar administratën tatimore të ndërmarrë veprimet e duhura në një kohë sa më të shpejtë.

VI. Përgjigje nga moduli i riskut për subjektet që kanë kërkuar rimbursim:
Për rimbursimin ekzekutohet risk run i veçantë në modulin e riskut. Ky risk run përbëhet nga 14 kritere të cilat kanë në logjikën e tyre TVSH-në. Pas këtij ekzekutimi, i kthehet përgjigje DRTVSH për subjektet për të cilat kërkojnë informacion bazuar në rregulloren e TVSH-së.

VII. Përmirësimi i ndarjeve të sektorëve ekonomikë: Për të ecur paralelisht me standartet ndërkombëtare të raportimit, për të rritur fuqinë identifikuese të modulit të riskut dhe për një analizë sektoriale më të thelluar, lindi nevoja për një riklasifikim të sektorëve ekonomikë. Ky përmirësim i ndarjeve sektoriale ka ndikim shumë pozitiv në përzgjedhjen që bën moduli për TP me risk të lartë pasi ndikon drejtëpërdrejtë në rezultatet sa më të sakta të kritereve, të cilat krahasojnë TP, me sektorin në të cilin ai bën pjesë. Zgjerimi i Sektorit të Tregtisë në më shumë nënsektorë ekonomikë është bërë duke parë: Hendekun tatimor; Peshën e tatimpaguesve; Rënien e ndjeshme të TVSH-së, parë kjo në analizën e TVSH së 6 mujorit.

VIII. Analizë sektoriale për sektorin ekonomik “Bar- Restorante”: DMR me asistencën e FMN- së, në kuadër të hartimit të projekteve sektoriale identifikoi, vlerësoi dhe prioritizoi si sektor të mundshëm për t’u trajtuar, sektorin me aktivitet “ Bar- Restorante”. Hapat që janë ndërmarrë deri në dhjetor 2018 për trajtimin e këtij sektori janë si më poshtë:

- Identifikimi i Risqeve
- Identifikimi i shkaqeve
- Vlerësimi dhe prioritizimi i risqeve

- Analizimi i arsyeve të sjelljes mospërmbushëse (motivi) dhe i mënyrave se si mospërmbushin tatimpaguesit (mundësi)

Në kuadër të këtij projekti u bazuam në analizën e thelluar lidhur me numrin e punonjësve, pozicionet e punës dhe nivelin e pagave për pozicion, për të gjithë popullatën duke evidentuar sektorin e "Bar-Restoranteve".

**Problematikat e evidentuara në këtë analizë janë:**

- Numri i lartë i punonjësve që deklarojnë paga minimale
- Numri i lartë i subjekteve që deklarojnë 1 ose 2 punonjës

Janë trajtuar dhe pikat si më poshtë:

- Profillizimi & ndarja e popullatës
- Indikatorët e përmbushjes
- Analiza e fenomenit Fenix
- Analiza e qarkullimit të kasave (2017-2018)
- Analiza e blerjeve në raport me shitjet në deklaratat e TF dhe TFTH.
- Informacion sasior & cilësor nga palët e treta (INSTAT, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Inspektoriati i Punës dhe Universiteti i Tiranës

Ky proces është në vijim dhe do të finalizohet me një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës veprimesh për trajtimin e risqeve.

# VI. MBLEDHJA ME FORCË

Në zbatim të detyrave operacionale, menaxhimi i borxhit gjatë vitit 2018 është mbështetur në objektivat strategjikë dhe është përqëndruar në garantimin e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, duke siguruar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve, uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve dhe në të njëjtën kohë, evidentimit sa më real të gjendjes së borxhit tatimor. Gjatë vitit 2018 janë ndërmarë një varg iniciativash për funksionin e mbledhjes, me fokus forcimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e proceseve të punës, lehtësimin e proceseve të komunikimit me tatimpaguesit me qëllim ndjekjen e menjëhershme të borxhit të ri, duke parandaluar kthimin e tij në borxh të vjetër për mos përshkallëzimin e stokut të borxhit aktual.

Sipas të dhënave të evidentuara nga evidencat që raportohen çdo muaj, ecuria dhe gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

| | |
|---|---|
| Gjendja e detyrimeve të papaguara në afat në datë 01.01.2018 | 95.5 mld lek |
| Gjendja në datë 31 Dhjetor 2018 | 107.7 mld lek |

Për këtë vit janë arkëtuar 18.4 mld Lek dhe janë sistemuar 2.3 mld Lek.

Viti 2018 krahasuar me vitin 2017, vit ku ka qenë në zbatim Ligji Nr 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore”, ka patur një rritje të borxhit tatimor. Gjatë këtij viti, Administrata Tatimore ka synuar mbajten në kontroll të treguesit të detyrimeve të shtuara, të cilat janë 33,2 mld lekë ose 33% më pak se viti 2017.

Në borxhin prej 107.7 mld lekë, i cili ndiqet deri më 31 Dhjetor 2018, është e përfshirë edhe vlera prej 13.9 mld Lek, e cila është në proces gjyqësor, që deri në fund të Dhjetor 2017 zë 13% të stokut të borxhit.

DRT Korçë dhe DTM janë drejtoritë të cilat kanë performuar më mirë gjatë këtij viti, ku borxhi ka pësuar rënie krahasimisht me fillimin e vitit.

**Borxhi sipas Llojit të Tatimit**

Grafik 2. Struktura e borxhit tatimor sipas llojit të tatimit




Në stokun e borxhit të ndarë sipas llojit të tatimit, TVSH zë peshën më të madhe me 37%, e ndjekur nga Tatim Fitimi me 28%, zëri Të Tjera me 21%, Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 13% dhe TAP me 1%.

Grafik 3. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2017 vs 2018




Krahasuar me fundin e vitit 2017, gjatë këtij viti TAP ka qëndruar në të njëjtin nivel, ndërkohë që TVSH është rritur me 4.7 mld lekë, Tatim Fitimi me 3.4 mld lekë, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore me 2.6 mld lekë dhe zëri Të Tjera me 1.4 mld lekë.

Grafik 4. Mosha e borxhit




Në total stokun e borxhit 107,7 mld lekë, borxhi sipas vjetërsisë paraqitet si më sipër ku:

- *borxhi deri në 3 muaj* ***7% ndaj totalit të stokut***
- *borxhi nga 3 - 6 muaj* ***8 % ndaj totalit të stokut***
- *borxhi nga 6-12 muaj* ***12 % ndaj totalit të stokut***
- *borxhi nga 1-2 vjet* ***17% ndaj totalit të stokut***
- *Borxhi me vjetërsi mbi 2 vjet* ***vlerë 60.8 mld Lekë*** *është* ***56% ndaj totalit të stokut***

Grafik 5. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit




- Subjektet Aktiv zenë 41% të numrit total të subjekteve debitore me një vlerë prej 46,3 mld lek ose 43% të masës totale të borxhit.

- Subjektet Pasiv zenë 59 % të numrit total të subjekteve debitore me një vlerë prej 61,4 mld lek ose 57% të masës totale të borxhit.

Me qëllim vetëpërmbushjen e detyrimit nga ana e tatimpaguesve, rekuperimit të detyrimeve të vetëdeklaruara pa u kthyer në borxh dhe parandalimi i krijimit të detyrimeve të reja, në bashkëpunim me Qendrën e Thirrjeve, janë kontaktuar nga Qendra e Thirrjeve dhe Drejtoritë Rajonale, të gjithë tatimpaguesit të cilët deklaruan dhe nuk paguajnë në afat detyrimet tatimore për çdo lloj tatimi (TVSH, Sigurime Shoqërore Shëndetësore, TAP, Tatimin në Burim,etj).

Bazuar në parimin e zbatimit të njëjtë dhe efektiv të legjislacionit nga ana e administratës tatimore gjatë vitit 2018, pas mbarimit të ligjit 33/2017 "Për fshierjen/shaurjen e detyrimeve tatimore të papaguara…", nga Drejtoria e Mbledhjes me Forcë u hartua "Plani mbi ndjekjen e tatimpaguesve që nuk shfrytëzuan mundësitë e përfitimit nga ligji i faljes".

***Si rezultat i këtij plani :***

- U dërgua ***"Njoftim" në llogarinë e-filling për 93.234 tatimpagues me vlerë detyrimi 51,18 mld lekë***. Nga subjektet pontencialisht përfituese të ligjit 33/2017 ***kanë likujduar detyrimet 3.160 tatimpagues me vlerë 0,89 mild lekë***.
- U kontaktuan nga ***Qendra e Thirrjeve 8.284 tatimpagues që nuk shfrytëzuan mundësitë e përfitimit nga ligji i faljes*** dhe rezultoi se nga muaji ***Maj 2018 deri në 20.09.2018 likujduan detyrimet 896 tatimpagues me vlerë totale 560 milionë lekë.***
- Nga DRT-të u kontaktuan ***3.772 tatimpagues me detyrim 1,33 mild lekë*** dhe rezulton të kenë paguar ***83 tatimpagues me 9,2 milionë lekë.***
- Nga zbatimit i procedures mbi monitorimi e xhiros, u konfiskua 50% e xhiros në bazë të nenit 89, për ***173 tatimpagues, nga të ciëet u arkëtuan 20,3 milionë lekë***.

U rifreskuan masat shtënguese për ***11,243 tatimpagues me një total detyrimesh 47,6 miliardë lekë.*** Gjatë vitit 2018 është implementuar në sistemin C@TS dhe në E-filing ***funksionaliteti "Akt Marrëveshja me Këste"***, modul aktualisht i disponueshëm për të gjithë përdoruesit..

Implementimi i këtij moduli vjen në zbatim të nenit 77 e vijues i Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. Ligji ka përcaktuar rrethanat për të cilat tatimpaguesi mund të kërkojë lidhjen e marrëveshjes të pagesës me këste të detyrimit tatimor të papaguar, kushtet që duhen përmbushur për lidhjen e kësaj marrëveshje, ndjekjen dhe zbatimin e saj.

# VII. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

Garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që trajton Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, është parim primar për vetë institucionin.

Nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike janë trajtuar 1145 shkresa për të siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen vullnetare.

Janë publikuar:

- 47 njoftime lidhur me rritjen e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri, në ndërfaqen e tatimeve (https://www.tatime.gov.al/c/8/45/lajme) dhe rreth
- 40 materiale informuese në rubrikën "Tatimet këshillojnë".
- 4 buletine për të garantuar informimin e tatimpaguesve. Nga këto, 2 buletine kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave për raste të lidhura me çështjet tatimore dhe 2 buletine teknike të administratës tatimore, që kanë të bëjnë me raste specifike dhe orientime për zbatimin e legjislacionit tatimor, të publikuara në ndërfaqen e tatimeve (https://www.tatime.gov.al/c/8/129/133/vendime-gjyqsore-te-formes-se-prere).

Në kuadër të garantimit të asistencës teknike dhe ligjore për Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe tatimpaguesit janë draftuar një sërë urdhëresash të brendshme, lidhur me unifikimin e praktikave tatimore dhe më konkretisht përmendim disa nga shkresat sqaruese:

- ✓ Për procedurat që do të ndiqen për përfshirjen e bisnesit të vogël në skemën e TVSH-së;
- ✓ Për procedurat lidhur me aplikimet për mbyllje/pezullime aktiviteti dhe hapjen e NIPT- eve të reja nga personat e lidhur;
- ✓ Për rregullshmërinë dhe zbatimin e kërkesave ligjore në kontrollet tatimore në rimbursimin e TVSH-së;
- ✓ Për trajtimin e OJF-ve për efekt të TVSH-së;
- ✓ Për Trajtimin e shoqërive të klasifikuara nën regjimin e përpunimit Aktiv;
- ✓ Për verifikimin, vlerësimin dhe llogaritjen e tatimit në burim për ambientet e dhëna me qera për qëllim të ushtrimit të një aktiviteti tregtar;

- ✓ Për dënimet/penalizimet e tatimpaguesve banka apo institucione financiare.

Janë trajtuar mbi 40 akte ligjore e nënligjore të përcjella nga MFE lidhur me legjislacionin tatimor dhe është dhënë opinion mbi to.

Janë propozuar ndryshime ligjore për sa i përket ligjit për: Procedurat tatimore; Tatimit mbi të ardhurat; Tatimin mbi vlerën e shtuar etj, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë marrë në konsideratë nga MFE. Këto ndryshime kanë sjellë edhe ndryshime në deklaratat tatimore si, lojërat e fatit dhe deklaratën e TVSH –së për biznesin e vogël, e cila është thjeshtuar.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional janë finalizuar**:**

- ✓ Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet DPD – DPT si dhe Procedurat Standarde të Veprimeve midis DPD – DPT.
- ✓ Marrëveshja ndërjmet DPPPParave dhe DPT, “Për shkëmbimin e informacionit dhe dhënien e të drejtës së konsultimit në bazën e të dhënave të DPT.
- ✓ Ndryshime në marrëveshjet e lidhura me ADISA etj

Drejtoria Ligjore dhe Teknike ka marrë masa në përmirësimin e përfaqësimit cilësor në konfliktet gjyqësore, përgatitjen e provave dhe prapësimeve etj.  Administrata tatimore është përfaqësuar profesionalisht në 132 çështje të lidhura me marrëdhënie pune, nga të cilat në Gjykatën Civile janë gjykuar 44 konflikte gjyqësore me ish-punonjës të kontraktuar me kontratë punësimi dhe në Gjykatën Administrative ka patur në trajtim 88 konflikte gjyqësore me palë ish-nëpunës civilë të konfirmuar.

# VIII. TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

**Mbajtja në funksion e sistemit tatimor**

✓ Drejtoria TIK asistoi palën furnitore për instalimin dhe konfigurimin e gjithë ndryshimeve në sistemet C@TS dhe "Tatimet e mia".

- Implementimi në sistemin e-tax të ndryshimeve ligjore për përfshirjen e Biznesit të Vogel në skemën e TVSH-së.
- Implementimi në sistemin e-tax të ndryshimeve ligjore për kategoritë e reja të profesioneve në deklarimin e listëpagesës.
- Implementimi në sistemin e-tax të ndryshimeve ligjore për deklarimin e tatimit të lojërave të fatit sipas Ligjit 155/2015 të ndryshuar.
- Implementimi i pagesës me këste për mbledhjen e borxhit.
- DPT në bashkëpunim me INSTAT dhe QKB përditësoi në sistemin e-tax, kodin Nace Rev 2 për 45 mijë tatimpaguesit për të cilët ky kod mungonte.
- Implementimi në sistemin e-tax i ndryshimeve ligjore të paketës fiskale 2019.

✓ Drejtoria TIK asistoi për identifikimin e problemeve, konceptimin dhe realizimin e zgjidhjes së problemeve të shfaqura gjatë funksionimit të sistemit.

✓ Për të gjitha shtesat dhe ndryshimet e bëra në aplikime është marrë pjesë në hartimin kërkesave, planeve të testimit dhe në procesin e testimit të funksionaliteteve të sistemit.

1. Implementimi në sistemin tatimor i shkëmbimit elektronik të të dhënave:

   ✓ Mundësimi i pagesës online të 13 tatimeve nëpërmjet e-payment në portalin e-albania

   ✓ Shkëmbimi elektronik i të dhënave të sistemit të tatimeve me sistemin e QKB.

2. Ndërtimi i raporteve standarte në sistemin CATS dhe ndërtimi i raporteve ad-hoc

3. Implementimi dhe mbajtja në funksion e sistemeve të tjera informatike në ndihmë të tatimpaguesve dhe administratës tatimore

✓ Sistemi M-TAX

✓ Mirëmbajtja e sistemit të pajisjeve fiskale

✓ Mirëmbajtja e sistemit të Qendrës së Thirrjeve

✓ Mirëmbajtja e faqes ËEB të tatimeve

✓ Përmirësimi i modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit (Funksionimi i sistemit të pajisjeve fiskale për transmetimin e kuponit në kohë reale dhe faturës elektronike).

## IX. RIMBURSIMI I TVSH-SË

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, në bashkëpunim me DRT-të gjatë vitit 2018 ka analizuar dhe trajtuar kërkesat për rimbursim të TVSH-së në përputhje me Ligjin 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, në Ligjin Nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën eE Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Gjate vitit 2018 administrata tatimore ka rimbursuar 14 396 783 mije lekë . Krahasuar me një vit më parë, rimbursimet janë rritur në vlerë 505 998 mijë lekë , ose 3.6% më shumë.

Përveç bazës ligjore të përcaktuar egziston një bazë dokumentare mbi të cilën punon tashmë Drejtoria e Rimbursimit si më poshtë:

- Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë;
- Rregullorja "Për rimbursimin e TVSH-se" mbështetur në analizën e riskut e datës 13.01.2017 e rishikuar me Urdhër 23, datë 23.03.2018, me nr.6374 prot, datë 23.03.2018;
- Manuali i Drejtorisë së Rimbursimit , i datës 05.02.2017;
- Plani Operacional i Drejtorisë së Rimbursimit.

Nëpërmjet Manualit u arrit që të sigurohej kuadri i nevojshëm rregullator, lehtësimi dhe zbatimi me përpikmëri i legjislacionit tatimor në fushën e rimbursimit të TVSH-së si dhe unifikimi i proçedurave të ndjekura lidhur me trajtimin e praktikave.

Theksojmë se një dokument mjaft i rëndësishem në punën e kësaj drejtorie është Rregullorja për rimbursimin e TVSH-se mbështetur në analizën e riskut, ku qëllimi i saj kryesor është vendosja e rregullave dhe proçedurave që duhet të ndjekin Drejtoria e Rimbursimit, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe DRT-të që janë të përfshira në proçesin e rimbursimit të TVSH-së.

Trajtimi i kërkesave bëhet brenda 2 ditëve nga data e marrjes së kërkesës duke mbajtur një Akt Evidentimi në të cilin përshkruhet hollësisht evidentimi dhe plotësimi i kritereve për të pranuar ose jo, kërkesën për rimbursim.

Në varësi të rezultatit të analizës paraprake nga Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së është bërë pranimi ose mospranimi i kërkesave për rimbursim të TVSH-së.

Gjatë vitit 2018, pranë DRTVSH-së janë paraqitur gjithsej 1390 kërkesa, nga të cilat nuk janë pranuar 403 kërkesa për mosplotësim të kritereve ligjore dhe janë pranuar 987 kërkesa me vlerë 22,2 miliardë lekë ose e shprehur në përqindje rreth 5% kërkesa më shumë se viti 2017 .

Situata e kërkesave të pranuara gjatë vitit 2018 sipas periudhës së depozitimit të kërkesës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 14. Kërkesat e pranuara gjatë vitit 2018

| | Periudha e paraqitjes së kërkesës | Nr i kërkesave që plotësojne kërkesat ligjore | Vlerë e kërkuar për rimbursim (000) lekë |
|---|---|---|---|
| 1 | Janar 2018 | 84 | 988,887 |
| 2 | Shkurt 2018 | 77 | 1,908,421 |
| 3 | Mars 2018 | 47 | 765,520 |
| 4 | Prill 2018 | 91 | 2,855,548 |
| 5 | Maj 2018 | 105 | 2,233,201 |
| 6 | Qershor 2018 | 107 | 2,181,412 |
| 7 | Korrik 2018 | 88 | 2,068,426 |
| 8 | Gusht 2018 | 74 | 3,458,495 |
| 9 | Shtator 2018 | 68 | 1,176,659 |
| 10 | Tetor 2018 | 90 | 1,600,746 |
| 11 | Nëntor 2018 | 72 | 1,363,886 |
| 12 | Dhjetor 2018 | 84 | 1,627,221 |
| | **Total viti 2018** | **987** | **22,228,422** |

Në totalin e shumës së kërkuar për rimbursim gjatë vitit 2018, 45.6 % e zë kategoria e eksportuesve, fasone dhe grumbullues, 35% kategoria e investimit, 1% ent publik, 18.4 % aktivitete të tjera.

Situata e rimbursimit për kërkesat e periudhes Janar – Dhjetor 2018 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

## Tabela 15. Situata e rimbursimit për vitin 2018

| | | Nr | Vlerë (000 lekë) |
|---|---|---|---|
| | Kërkesa | 987 | 22,228,422 |
| | Miratuar | 822 | 16,600,343 |
| **Nga këto:** | rimbursuar/kompensuar | | 15,700,536 |
| | *me rimbursim Cash* | | *14,394,317* |
| | *me kompensim* | | *1,194,019* |
| | | | |
| | Pa kontrolluar | 160 | 3,890,582 |
| | Refuzuar | 5 | 207,265 |
| | Tërhequr nga kërkesa | - | - |

## Tabela 16. Rimbursimet sipas DRT-ve

| DRT | Rimbursime për kërkesa të vitit 2018 ( milionë lekë) | |
|---|---|---|
| | **Rimbursim nga DPT** | **Nr.Tatimpaguesve** |
| **Berat** | 270 | 36 |
| **Dibër** | 30 | 3 |
| **Durrës** | 1,154 | 172 |
| **Elbasan** | 621 | 23 |
| **Fier** | 947 | 102 |
| **Gjirokastër** | 81 | 13 |
| **Korçë** | 240 | 33 |
| **Kukës** | 93 | 7 |
| **Lezhë** | 46 | 6 |
| **Sarandë** | 41 | 7 |
| **Shkodër** | 293 | 35 |
| **Vlorë** | 171 | 31 |
| **Tiranë** | 2,180 | 208 |
| **DTM** | 8,076 | 146 |
| TOTAL | **14,244** | **822** |

Eshtë realizuar si aktivitet operacional, kryerja e procedurës së rimbursimit automatik për tatimpaguesit eksportues të kategorizuar me risk zero sipas kritereve përcaktuara në VKM 953 datë 29.12.2014, ku nga totali i kërkesave për rimbursim në vitin 2018, 39 kerkesa janë konsideruar me

risk zero duke mos ju nënshtruar analizës së riskut, e cila ka sjellë përfundimin e proçedurës së miratimit të rimbursimit menjëhere, ku vitet e kaluara ky numër ka qenë i papërfillshëm.

Rimbursimi i Tvsh vijon të mbetet një shqetësim i AT në marrëdhënien e saj me sipërmarrjen. Viti që lamë pas, shënoi cilësi si në drejtim të përmirësimit të procedurës së rimbursimit (rimbursim në bazë të riskut), uljes së numrit të kontrolleve tatimore për rimbursim dhe në drejtim të shumës së rimbursuar e më konkretisht;

- Gjatë vitit 2018 pati një rritje të numrit të kërkesave për rimbursim nga 941 kërkesa në vitin 2017, në 987 kërkesa ose 5 % më shumë se viti i kaluar.
- Gjatë 2018 u rimbursuan 14.4 miliardë lekë TVSH, krahasuar me vitin e kaluar kjo shifër e shprehur në % është 9,3% më shumë se ne vitin e kaluar apo 1.2 miliardë lekë më shumë;
- Gjatë vitit 2018, 25% e kërkesave është miratuar pa kontroll, praktikë kjo e bazuar në analizën e riskut implementuar në fillim të vitit 2017 dhe e rishikuar me rregulloren "Për rimbursimin e TVSH-së mbështetur në analizën e Riskut" të miratuar më datë 23.03.2018. Në vitet e kaluara numri i kërkesave që rimbursoheshin pa kontroll përbënte 5% të tyre.

# X.MARËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL

Drejtoria e Marëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional organizon dhe koordinon marëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtare, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare, por gjithashtu edhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Parlamenti me ligj. Në çdo kohë kjo drejtori siguron zbatimin e drejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore dhe garanton mbrojtjen e interesave të tatimpaguesve shqiptarë në raport me transaksionet dhe marrëdhëniet me administratat tatimore të huaja.

Ndër detyrat kryesore që kjo Drejtori ka ndjekur gjatë vitit 2018 përmendim:

- Siguron mbarëvajtjen e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe të administratës tatimore me organizmat vendase dhe të huaja.
- Raporton në strukturat e linjës lidhur me proceset e integrimit të vendit në BE.
- Siguron zbatimin korrekt, të paanshëm dhe jodiskriminues të legjislacionit tatimor dhe marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.
- Ndjek dhe asiston në nivel teknik Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në negociatat për marrëveshjet tatimore.
- Garanton shkëmbimin e informacionit me vendet me të cilat ka një marrëveshje tatimore në fuqi si dhe me vendet anëtare të Forumit Global.

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional, në kuadër të ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative për tatimpaguesit:

- Iu është përgjigjur mbi **2,100 kërkesave** nga tatimpaguesit për zbatimin e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për shmangien e taksimit të dyfishtë, që Shqipëria ka lidhur me 40 shtete;
- Iu është përgjigjur mbi **600 kërkesave** të tatimpaguesve dhe individëve për t'u pajisur me çertifikatë rezidence;
- Iu është përgjigjur **110 kërkesave** për shkëmbim informacioni nga administratat tatimore homologe.
- Ka asistuar drejtoritë e tjera brenda DPT si dhe Drejtoritë Rajonale në lidhje me probleme dhe paqartësi në zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë;

- Ka përpiluar programet e trajnimit dhe ka trajnuar stafin e ri / aktual të administratës tatimore mbi zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë.

Gjithashtu kjo Drejtori ka dhënë kontributin e vet edhe për: Pjesëmarrje në grupin e punës të ngritur në kuadër të Projektit Pilot për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, që po zbatohet me ndihmesën e Bankës Botërore, OECD dhe Administratës Tatimore Italiane;

**Pjesëmarrje në grupe pune në nivel ndërministror:**

Bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Financave duke marrë pjesë në grupe negociatash për arritje marrëveshjesh të reja ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë si dhe duke dhënë mendime për akte ligjore dhe nënligjore në lidhje me çështje tatimore.

**Shkëmbimi i eksperiencave dhe pjesëmarrje:**

- Gjatë vitit 2018, në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave, studimit dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit, Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional ka organizuar pjesëmarrjen e stafit të Administratës Tatimore në aktivitetet si vijon:
    - 7 seminare/trajnime (13 punonjës të trajnuar) organizuar nga *Organizata Ndër-Europiane e Administratave Tatimore* (**IOTA** - organizatë jo-fitimprurëse ndërqeveritare që nxit bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore në rajonin e Evropës dhe mbështet zhvillimin e tyre në përputhje me nevojat e tyre individuale).

    - 6 seminare/trajnime (18 punonjës të trajnuar) organizuar nga *Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim* (**OECD** - ka për mision nxitjen e politikave në përmirësimin ekonomik dhe social të mirëqenies së njerëzve në mbarë botën)

    - 6 seminare/trajnime (13 punonjës të trajnuar) organizuar Qendra e Ekselencës Financiare (**CEF** - organizatë ndërkombëtare me mision mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve për zyrtarët e financave në Evropën Juglindore).

    - 8 seminare/trajnime (18 punonjës të trajnuar) organizuar në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin e BE-së **Fiscalis 2020**. Gjithashtu, në kuadër të po këtij programi janë zhvilluar **2** vizita studimore pranë administratave tatimore homologe.

    - 1 seminar (12 punonjës të trajnuar) organizuar (në Tiranë) në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin e BE-së **Taiex**.

- o Janë pritur 3 vizita studimore nga administrata tatimore të huaja.

- o Pjesëmarrje në 2 (dy) aktivitete ndërkombëtare ( nga 1 përfaqësues) **me kërkesë të Ministrisë së Financave** mbi *Procesin e vlerësimit nga Moneyval*, i cili u zhvillua në Strasburg si dhe në *Takimin e Nivelit të Lartë mbi Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Taksimit,* zhvilluar ne Tiblisi, Gjeorgji.

- Në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh është kryer një vizitë studimore pranë një administrate homologe dhe janë pritur dy delegacione me përfaqësues nga administratat homologe.

  Në kuadër të progresit organizativ të Administratës Tatimore dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore si dhe zhvillimit e përmirësimit të partneriteteve, Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional:
- Ka dhënë kontribut në përgatitjen e informacioneve mbi progresin e Administratës Tatimore Shqiptare, në kuadër të rekomandimeve të Raportit Analitik të Komisionit Europian, në zbatim të MSA-së dhe Raport-Progresit të Shqipërisë për vitin 2018 (për kapitullin 16 "Tatimet" dhe kapitullin 33 "Kriteri Ekonomik") apo raportimeve në kuadër të PKIE (Planit Kombëtar të Integrimit).
- Ka organizuar dhe mbikëqyrur procesin e raportimit të administratës tatimore në kuadrin e raportit të përvitshëm "*Doing Business*" të Bankës Botërore
- Në kuadër të Raportimit për Monitorimin 6-mujor të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike- *PFM Action Plan*, është përgatitur informacioni tabelor dhe në mënyrë narrative për Komponentin 3.1 '*Tax Administration'*
- Në kuadër të *Procesit të Vlerësimit të Aktit të Biznesit të Vogël 2016- 2019,* bazuar në *SME Policy Index* për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, është plotësuar, sipas fushave të përfshirjes, formulari *Dimension 4, Sub-dimension 4: Tax compliance procedures for SME*

## XI. MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve ndjek dhe koordinon ecurinë e zbatimit të çdo projekti me financim të brendshëm apo të huaj, që zhvillohet në Administratën Tatimore, që ndërlidhet me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë: Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare etj.

Bazuar në objektivat strategjike të Administratës Tatimore janë përmbushur përgjatë vitit 2018 aktivitete operacionale si përditësimi i planit të ndërhyrjeve/asistencës si dhe evidentimi i nevojave për projekte të reja; identifikimin e donatorëve të mundshëm për zbatimin e planit dhe bashkëpunim si BERZH, Banka Botërore dhe FSVC/USAID, si dhe krijimi i mjeteve informuese për tatimpaguesit dhe individët, pranë Shërbimit të Tatimpaguesve. Gjatë vitit 2018 u krijua platforma Helpdesk, një sportel i vecantë informues për tatimpagues dhe individë pranë qëndrave ADISA. U hartuan dhe u printuan 11 broshura informuese në konsultim me ekspertët e kontraktuar nga BERZH dhe specialistët e DPT-së, si dhe u përgatitën 11 video informuese, të cilat u publikuan në faqen www.tatime.gov.al. Ky projekt pritet të përfundojë në vitin 2019.

Në fokus të veçantë ka qënë dhe rritja e kapaciteteve të inspektorëve të kontrollit tatimor. Në kuadër të Projektit ‘’Për forcimin e edukimit të kontabilitetit dhe auditimit për hartuesit e pasqyrave financiare dhe punonjësit tatimor dhe rritja e kapaciteteve teknike të profesioneve të kontabilitetit dhe auditimit’’, përfundoi pjesa e trajnimeve parashikuar për vitin 2018. U trajnuan në total 240 inspektorë kontrolli të administratës tatimore qëndrore dhe rajonale për standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.

Në zbatim të objektivit për mbajtjen e proçeseve optimale gjatë vitit 2018 u organizuan vizita nga ekspertë të huaj, të FMN dhe FCVC/USAID, me qëllim ofrimin e asistencës dhe praktikave më të mira ndërkombëtare për: Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë, Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, Drejtorinë e Hetimit Tatimor si dhe Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Si një projekt shumë i rëndësishëm, projekti për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, zbatimi i të cilit filloi në fillim të vitit 2018 me dy takime të Steering Committee, takime me grupin e punës dhe hartimin e ligjit me asistencë të ekspertëve italianë dhe ekspertëve nga OECD, u arrit në finalizimin e draftit përfundimtar të ligjit për Shkëmbimin Automatik të Informacionit. Ky projekt pritet të përfundojë në vitin 2020 ku dhe do të fillojë zbatimi i tij.

## XII. QENDRA E PAGESAVE

Gjatë vitit 2018 Qendra e Pagesave ka ndjekur, përgatitur dhe raportuar në kohë dhe me saktësi informacionin mbi pagesat e kryera në bankat e nivelit të dytë dhe në thesar, lidhur me të ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Puna e kësaj drejtorie gjatë vitit 2018 është fokusuar në:

- Marrjen dhe Krahasimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.

- Komunikimin me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në funksion të mbarëvajtjes së punës dhe saktesisë së informacionit. Numri i komunikimeve elektronike për zgjidhjen e problematikave të konstatuara gjatë vitit 2018 ka qenë 234.

- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes mes Ministrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 806 raste për vitin 2018.

- Përgatitjen e raporteve ditore , mujore dhe progresive të të ardhurave tatimore dhe kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqërore dhe shendetesore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për çdo drejtori rajonale tatimore pas rakordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënia e këtyre raporteve në dispozicion të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës dhe strukturave drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve .

- Komunikimin e vazhdueshem me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt- Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga administrate tatimore apo të ndonjë problemi te lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshje me bankat e nivelit të dytë. Gjate vitit 2018 jane kryer 113 komunikime elektronike me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit për problematika të ndryshme.

# XIII. HETIMI TATIMOR

Drejtoria e Hetimit Tatimor ushtron detyrat e saj në kuadër të parandalimit, zbulimit dhe hetimit, në përputhje me ligjin e proçedurave tatimore dhe legjislacionin penal apo proçedural penal, të kundravajtjeve administrative tatimore apo veprave penale në fushën e taksave dhe tatimeve.

Gjatë vitit 2018, bazuar në objektivat strategjikë të hartuara dhe miratuara si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi, Drejtoria e Hetimit Tatimor ka punuar dhe realizuar detyrat funksionale në zbatim të performancës së administratës tatimore në funksion të mbledhjes dhe realizimit të të ardhurave buxhetore dhe parandalimit të rasteve të evazionit tatimor.

Rezultatet e Drejtorisë së Hetimit Tatimor bazuar në Manualin e Hetimit Tatimor, Rregulloren "Për funksionimin e administratës tatimore qendrore", Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij, si dhe në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, kanë konsistuar në këto drejtime:

1. Kryerje e kontrolleve në territorin e RSH, me qëllim ndërgjegjësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve për kryerjen e çdo transaksioni tregtar në zbatim të ligjit duke lëshuar kuponin ose faturën tatimore, duke rritur në këtë mënyrë qarkullimin tregtar dhe nivelin e arkëtimeve. Në zbatim të detyrave funksionale, strukturat e hetimit kanë kryer kontrolle në përgjigje të shkresave dhe rasteve abuzive nga burime të ndryshme.

Gjatë gjithë vitit 2018, puna e strukturave të hetimit është orientuar mbi bazën e planeve operacionale, të cilët kanë evidentuar sektorë/qytete etj.me mangësi në përmbushjen vullnetare.

- Plani operacional i DHT miratuar me Vendim Nr.8 datë 24.01.2018, për periudhën **5 Shkurt-31 Mars 2018**, parashikonte kryerje të kontrolleve në tregje, në akset kryesore të lëvizjeve të mallrave dhe udhëtarëve si dhe kontrolle në tatimpagues në qendrat kryesore Tiranë, Fier, Durrës, Elbasan.
- Plani operacional i Drejtorisë së Hetimit Tatimor miratuar me Vendim Nr.11 datë 21.03.2018, për periudhën **2 Prill - 31 Maj 2018**, konsistonte në kontrolle në tatimpagues pasivë për të shmangur cdo rast abuzimi me legjislacionin tatimor. Në fokus të këtij plani, kanë qënë kontrollet në subjekte të fushës së ndërtimit dhe hotelerisë si dhe tatimpagues të pakontrolluar më parë nga administrata tatimore.

- Plani turistik i Drejtorisë së Hetimit Tatimor me nr. 12633 prot datë 14.06.2018, për periudhën **16 Qershor - 30 Shtator 2018,** ka patur në fokus kontrolle në tatimpaguesit e zonave turistike për të garantuar përmbushjen e legjislacionit tatimor.
- Plani operacional i Drejtorisë së Hetimit Tatimor miratuar me Vendim Nr. 12 datë 21.09.2018 prot me numër 19820 datë 21.09.2018, për muajin **Tetor 2018**, konsistonte në orientim për kontrolle në pikat e karburanteve në të gjithë territorin e R.SH si dhe një shtrirje e strukturave të zbatimit për kontrolle në qendrat e qyteteve kryesore.
- Plan Operacional i DHT prot me numër 22354 datë 05.11.2018, për periudhën **5 Nëntor - 31 Dhjetor 2018,** konsistonte në evidentimin e tatimpaguesve me rënie të xhiros, të cilët më pas janë bërë objekt kontrolli, si dhe kontrolle në tregje dhe transport.

Gjithashtu është asistuar në terren, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara nga subjekte të përzgjedhur si problematikë në shlyerjen e detyrimeve.

Bashkëpunime të Drejtorisë së Hetimit Tatimor ka patur dhe me strukturat e Policisë së Shtetit dhe AMLF në zbatim të luftës mbi informalitetin në fushën e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2018 është shënuar bashkëpunimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor dhe Drejtorise së Përgjithshme të Doganave, mbi një plan masash të përbashkëta për evidentimin, parandalimin, dokumentimin, goditjen e tregëtimit në mënyrë të kundraligjshme të duhanit dhe nënprodukteve të tij.

2. Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Hetimit Tatimor në kryerjen e detyrave funksionale ka evidentuar subjektet të cilat kanë pasur detyrime tatimore dhe për të cilat janë marrë masat administrative, po ashtu ka evidentuar raste të subjekteve të cilët kanë kryer fshehje të të ardhurave, mashtrim me TVSH-në, ose vepra të tjera penale në fushën e tatimeve dhe të taksave. Për të gjitha këto raste janë marrë masat administrative përkatëse dhe për rastet të cilat kanë përmbushur elementët e figurave të veprave penale është bërë kallëzimi i tyre në Prokuroritë përkatëse, si dhe janë ndjekur detyrat e deleguara nga Prokuroria sipas rastit.

3. Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Hetimit Tatimor, është angazhuar dhe ka realizuar objektivin, në lidhje me progresin organizativ të administratës tatimore dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Në funksion të kësaj, është rishikuar dhe miratuar Manuali i Hetimit Tatimor me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. 28 datë 21.06.2018, me qëllim unifikimin e praktikave të ndjekura nga Drejtoria e Hetimit.

Janë kryer disa trajnime për stafin duke u fokusuar në ndryshimet e legjislacionit, manualin e Drejtorisë së Hetimit dhe rregulloren e funksionimit për administratën tatimore qendrore. Kontrollet në territor Janar-Dhjetor 2018:

Grafik 6. Verifikimet në numër bazuar në plane operacionale dhe në ndjekje të shkresave sipas cdo Drejtorie Hetimi Tatimor.




| | Task Force DPT | Rajoni Qendror | Rajoni Jugor | Rajoni Verior | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| Plan | 5,974 | 9,036 | 9,859 | 4,284 | 29,153 |
| Shkresa | 157 | 6,853 | 3,275 | 558 | 10,843 |
| Total | 6,131 | 15,889 | 13,134 | 4,842 | 39,996 |

Grafik 7. Masa administrative në numër të vendosura për ata tatimpagues që nuk përmbushin legjislacionin tatimor.




Grafik 8. Shkelje në vlerë sipas rajoneve.



**Referime per veprat penale Janar-Dhjetor 2018**

Gjatë vitit 2018, Drejtoria e Hetimit Tatimor është angazhuar në parandalimin dhe zbulimin e rasteve të evazionit fiskal. Në lidhje me këtë janë arritur rezultatet si më poshtë:

Tabela 17. Rezultatet e vitit 2018

| | **JANAR-DHJETOR 2018** | | | |
